



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 5571 Prot.

Tiranë, më 10/09/2020

URDHËR

Nr. 304 datë 10/09 2020

“PËR

**AUTORIZIMIN E ORGANIZATËS JOFITIMPRURËSE ‘FORUMI I GRUAS
ELBASAN’ PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE
TË GARANTUAR NGA SHTETI”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të neneve 13, shkronja “b” dhe 15 të ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, të vendimit nr.55, datë 06.02.2019 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”,

KONSTATOJ SE:

Organizata jofitimprurëse “Forumi i Gruas Elbasan, e regjistruar si organizatë jofitimprurëse me vendimin nr. 4030/1, datë 10.07.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, identifikuar me NUIS K52609201K, me adresë Lagja “5 Maji”, Rruga “M. Shqiptari”, Pall. 450/1 Elbasan, ka paraqitur aplikimin për autorizim për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas më datë 13.05.2020, protokolluar me nr. 157, datë 13.05.2020

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas ka marrë në shqyrtim aplikimin për autorizim, me qëllim verifikimin e përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në nenin 15, të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, për ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe të dokumentacionit të dorëzuar.

Procedura e verifikimit të kriterëve ligjore dhe e vlerësimit të aplikimit për autorizim nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, sipas të dhënave që përmban relacioni vlerësues, është kryer brenda afatit të përcaktuar në pikën 9, të vendimit nr. 55, datë 06.02.2019 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”.

Sipas relacionit vlerësues përkatës të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, rezulton se aplikimi për autorizim është shoqëruar me dokumentacionin e përcaktuar në pikën 5, të vendimit nr. 55, datë 06.02.2019 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti” dhe është depozituar brenda afatit të përcaktuar në njoftim.

Bazuar në të dhënat e relacionit vlerësues mbi dokumentacionin e paraqitur dhe vlerësimin mbi përmbushjen e të gjitha kriterëve ligjore, si dhe propozimin nr. 278, datë 23.07.2020, të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, “Për autorizimin e organizatës jofitimprurëse ‘Forumi i Gruas Elbasan’ për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti”,

URDHËROJ:

1. Autorizimin e organizatës jofitimprurëse “Forumi i Gruas Elbasan”, e regjistruar si organizatë jofitimprurëse me vendimin nr. 4030/1, datë 10.07.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, identifikuar me NUIS K52609201K, me adresë Lagja “5 Maji”, Rruga “M. Shqiptari”, Pall. 450/1 Elbasan, për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
2. Ky autorizim është i vlefshëm për një periudhë dyvjeçare nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Etilda Gjonaj (Saliu)

